

Dr. Tahir Abdyli

### ZHVILLIMI I XEHETARISË DHE I INDUSTRIË NË MITROVICËN E TITOS NË PERIU DHËN E NDËRTIMIT SOCIALIST

Pas çlirimit të vendit nga okupatori fashist dhe pas ngadhjimit të Revolucionit Socialist në Jugosllavi, në Kosovë, pra edhe në Mitrovicën e Titos me rrethinë, para organeve të pushtetit popullor shtrohen detyra të mëdha e sidomos për rindërtimin dhe ndërtimin e vendit. Ky ishte synim themelor, sepse pa një zhvillim të tillë nuk mund të mendohej transformimi socialist në këtë trevë. Ndërtimi i socializmit nga masa e gjerë, e në radhë të parë, nga klasa punëtore kërkonte sakrifica të mëdha, në këtë plan gjenerata që barti luftën që e gatshme të vazhdonte me tërë qenien punën në rindërtimin e vendit. Mitrovica e Titos me rrethina është trevë e njohur me pasuri nëntoksore qysh në kohët e vjetra, në mesjetë, e sidomos bëhet e njohur në mes dy luftërave botërore. Në mes dy luftërave botërore fillojnë hulumtimet gjeologjike për xehe nga kapitali i huaj dhe si rezultat i këtyre kërkimeve themelohet ndërmarrja për mihjen dhe përpunimin e xehës „Trepça”, më 1928. Xehetaria para, gjatë dhe pasë Luftës Nacionalçlirimtare në këtë trevë ishte dhe mbeti dega kryesore e ekonomisë.

Zhvillimin e xehetarisë në këtë trevë mund të ndiqet nga themelimi i Trepçës deri në ditët e sotme. Prodhimtaria e xehes gjithnjë erdhi duke u shtuar, çka mund të shifet se prej vitit 1930 gjer më 1945 u prodhuan gjithsej 12.146.622 tonë xehe.<sup>1</sup> Që do të thotë mesatarisht rreth 506.000 tonë në vit. Në Trepçë që nga themelimi mund të vërehet se prodhimi i xehes u zvogëlua vetëm në vitin 1945, kur u prodhuan 121.459 tonë plumb dhe zink. Për ta vërejtur këtë prodhim, do të japim pasqyrën sipas viteve.<sup>2</sup>

<sup>1</sup> Ekonomski institut NR Srbije, *Razvoj proizvodnih snaga sreza zvečanskog*, Beograd 1955, 92.

<sup>2</sup> *Po aty*, 91.

Viti	Xehja në tona	Indeksi	Përmbajtja		Argjent gr/T
			Plumb %	Zing %	
1945	121.459	46,5	7,31	3,07	100
1946	430.383	164,9	6,82	3,47	98
1947	486.633	186,4	6,91	5,00	85
1948	531.573	203,7	7,22	5,48	87
1949	634.266	243,0	6,62	4,97	88
1950	665.191	254,8	6,54	4,77	94
1951	640.100	245,2	7,38	4,10	106
1952	584.465	223,9	9,91	4,31	100
1953	544.253	208,5	6,80	4,18	—
1954	518.636	198,7	6,91	3,78	—

Nga pasqyra vërehet se nga viti 1951 filloi një rënie e prodhimit të xehes, që ishte synim i kursimit të eksploatimit të xehes, prandaj në këtë periudhë iu dha rëndësi hulumtimit të rezervave të xehes, e cila, sipas shënimeve të vitit 1954, mund të shihet si vijon.<sup>3</sup>

	A	B	C	Gjithësej
xehë në tona	4.322.610	1.420.000	3.410.000	
plumb në %	7,5	5,5	4,0	9.152.610
zink %	3,7	3,5	2,5	

Nga të dhënat në sajë të analizave të bëra mund të shihet se në horizontet e reja xehja ishte më e varfë më metale. Në horizontin e pestë sipërfaqja me xehë përfshinte rreth 10.580 m<sup>2</sup>, në horizontin e gjashtë 7.186 m<sup>2</sup>, ndërsa përmbajtja e xehes me plumb në fillim ishte 12,84%, ndërsa në vitin 1950 kjo përqindje bie në 6,54%. Në mihjet e reja përqindja e metaleve ishte më e vogël, çka mund të merret si normale ku kihet parasysh thellësia e mihjes së xehes. Në vitin 1951 vërehet një rritje e sasisë së plumbit në xehë në 7,38%, ndërsa në vitin 1952 në 6,91%. Në vitin 1953 në 6,8%, e në vitin 1954 në 6,90%. Në këtë periudhë të zhvillimit të xehetarisë në Mitrovicën e Titos nga përpunimi i xehes brenda ditës në djerrina hudhën 1.500 tonë, në të cilat përbërja më elemente të ndryshme ishte: e sulfurit 25%, hekurit 30—40 dhe manganit 2,5—3%. Nga këto të dhëna shihet se xehja një kohë të gjatë është shfrytëzuar në mënyrë ekstensive. Më themelimin e Trepçës pronarët e saj ndërtuan edhe Flotacionin për fisnikërimin e xehes. Në fillim kapaciteti i flotacionit ishte përpunimi i 2000 tonë xehë në ditë, ndërsa në vitin 1949—1950 ky kapacitet zgjerohet në 3000 tonë xehë në ditë. Nga vitet pesëdhjetë në flotacion, përveç xehes së Trepçës, përpunohet edhe xehja nga Ajvalia, Janjeva dhe Kopaoniku. Paralelisht me përtërirjen e punimeve minerale në Trepçë, pas Luftës së Parë Botërore fillon edhe ndërtimi i shkretores

<sup>3</sup> Dr. Tahir Abdyli, *Zhvillimi i industrisë në Kosovë*, Prishtinë 1978.

dhe i rafinerisë së plumbit, ku më 1940 lëshohet në prodhim. Deri në këtë kohë përpunimi i koncentratit në metal bëhet në botën e jashtme. Pra, më 1940 u lëshohet në prodhim shkritoja e plumbit më rafineri dhe nga kjo kohë Trepça vet prodhon plumb, argjend dhe bizmut. Në fillim kapaciteti i shkrites ishte 28.000 tonë në vit. Gjatë okupacionit kapaciteti i shkrites zgjerohet. Më 1941 në Zvečan përpunohen 30.760 tonë plumb dhe ndahen rreth 16.000 kg argjend.<sup>4</sup> Në periudhën e rindërtimit dhe të ndërtimit socialist, më 1949 dhe më 1950 bëhet riparimi i shkrites, bëhen investime të reja, ndërtohen edhe gjashtë furra koritore dhe fërgorja për fërgimin e koncentreve të plumbit me madhësi 22 m.<sup>2</sup> Gjithashtu ndërtohet një furrëllart për përpunimin e koncentratit me përbërje më të dobët dhe të hedhurinave.

Në këtë periudhë bëhen investime të reja dhe zgjerohet rafineria e plumbit, e cila kompletohet me montimin e tetë kazanave të rinj treqind tonë me kapacitet prej 75.000 tonë në vit.<sup>5</sup> Riparimi dhe zgjerimi i shkrites bëri që kjo të jetë njëra ndër shkritoje më të mëdha në Evropë dhe të hyjë në mesin e dhjetë shkritesve më të mëdha në botë. Në këtë shkritoje nga viti 1949 përpunohen xehet edhe nga xeherorja e Ajvalisë, Janjevës, Koponikut, koncentratet që fitoheshin nga xeherorja e Novo-Bërdos, kurse më vonë në këtë shkritoje fillon të përpunohet koncentrat nga Rudniku, Leca, Zletova e Maqedonisë dhe nga Shupla Stena e Malit të Zi. Kapaciteti i shkrites dhe i rafinerisë deri në vitin 1954 shfrytëzohet 80—85%. Në Trepçë në këtë periudhë të zhvillimit të xehetarisë nga lënda e parë prodhohen vetëm disa elemente si plumbi, argjendi dhe bizmuti. Prodhimin e plumbit të rafinuar në Trepçë mund ta ndiqni si vijon.<sup>6</sup>

Viti	Tona	Indeksi
1940	14.234	100,00
1945	8.238	57,8
1946	25.007	175,6
1947	31.635	222,1
1948	37.685	264,6
1949	44.420	311,9
1950	46.464	326,2
1951	50.577	355,1
1952	58.283	409,1
1953	60.324	423,8
1954	56.108	393,9

Kurse vetëm nga xeherorja e Stari-Tërgut në Trepçë prodhohen këto sasi të plumbit të rafinuar.<sup>7</sup>

<sup>4</sup> Arkivi Ekonomik i Trepçës (AET), *Izveštaj i metabilans Topionice Zvečan za 1940/41.*

<sup>5</sup> *Trepça, Mitrovicë, 1974, 92.*

<sup>6</sup> Si vrejti 1, 96.

<sup>7</sup> *Po aty.*

Viti	Tona	Indeksi
1947	28.585	100,0
1948	31.957	111,8
1949	33.834	118,4
1950	35.640	124,7
1951	39.731	139,0
1952	34.166	119,5
1953	31.243	109,3

Prodhimi i plumbit në këtë periudh të zhvillimit të Trepçës është si prodhim final, që kryesisht eksportohet. Ndërsa koncentrat i zinkut në metal zink përpunohet në Cele dhe pjesa tjetër eksportohet. Në xehes e plumb-zinkut kishte edhe sasira të argjendit, ku gjatë procesit të përpunimit ndahen sasi të konsiderueshme të këtij metali të vlefshëm si metal i fisnikëruar 99,97%. Që të mund të eksportohet në tregun ndërkombëtar, ku fisnikëria e argjendit kërkohet të ishte 99,99%; më parë argjendi nga Trepça eksportohet në Gjermani ose Zvicërr, ku me anë të elektrolizës përfitohet argjendi me veti të fisnikëruar e pastaj si metal i çmuar eksportohet në vendet e ndryshme të botës.

Prodhimin e argjendit në Trepçë mund të shihet si vijon<sup>8</sup>

Viti	Kilogramë	Indeksi (1947=100)
1945	3.412.960	9,85
1946	7.317.580	21,12
1947	34.643.020	100,00
1948	44.922.500	129,67
1949	58.098.000	167,70
1950	68.585.980	197,97
1951	91.596.000	264,39
1952	77.588.000	223,96
1953	91.034.000	262,77
1954	84.094.920	242,74

Përveç argjendit, gjatë përpunimit të xehes në Trepçë përfitohet edhe Bizmuti, që hyn në përdorim në prodhimin e legurave të ndryshme. Ky prodhim i bizmutit në Trepçë mund të ndiqet si vijon.<sup>9</sup>

Viti	Kilogramë	Indeksi
1947	42.700	100,0
1948	51.000	119,42
1949	38.100	89,22
1950	56.280	131,80
1951	87.760	205,52
1952	98.700	231,14
1953	98.452	230,56
1954	109.699	256,90

<sup>8</sup> Po aty, 100.

<sup>9</sup> Po aty.

Në procesin e përpunimit në flotacion nga xeheja e plumb-zinkut përfitohet një sasi e koncentratit të piritit që mund të ndiqet deri më 1954 si vijon.<sup>10</sup>

Viti	Tonë	Indeksi
1948	63.136	160,48
1949	46.500	118,20
1950	28.162	71,50
1951	25.363	64,47
1952	30.103	76,52
1953	25.094	63,78
1954	24.530	62,35

Pjesa më e madhe e prodhimeve të Trepçës në këtë fazë të zhvillimit eksportohet në botën e jashtme. Më 1951 nga Trepça eksportohen 48.362 tonë plumb në vlerë prej 995.800.000 dinarë devizorë, që paraqet 94% të tërë eksportit të plumbit nga Jugosllavia. Në Trepçë më 1953 ishin të punësuar 4.776 punëtorë dhe nëpunës. Po në këtë vit në Trepçë realizohet një brutoprodukt prej 8.174.544.433 dinarësh amortizim prej 922.904.000 dinarësh, të ardhurat popullore 7.251.640.000, me fond të realizuar të të ardhurave 874.745.000 dhe akumulimi në fonde të tjera prej 6.376.894.933 dinarësh.

Në Mitrovicën e Titos me rrethinë në vitin 1956 të ardhurat për një banor ishin 186.813 dinarë, ndërsa në vitin 1958 ato arrijnë në 219.247 dinarë. Trepça si bartëse kryesore i zhvillimit të kësaj treve në këto të ardhura merr pjesë me 82%, ndërsa tërë ekonomia tjetër më 18%. Më 1959 në Mitrovicën e Titos ishin të inkuadruar 9.606 veta, prej tyre 1307 femra. Në këtë trevë, sipas planit 1957—1961, ishin të parapara investime në ekonomi prej 13.492.000.000 din. Nga këto mjete për industri parashiheshin të investoheshin 7.494.000.000 din.

Prodhimi i xehes në Mitrovicën e Titos me rrethinë mund të ndiqet sa vijon.<sup>11</sup>

Viti	Trepça Stari Tërg	Xeheroret Kopaonik Leposaviç	Kishnica dhe Novobërda	Gjithsejt xehe të prodhuar në tonë
1059	582.243	—	—	583.243
1961	605.594	—	—	605.594
1962	623.934	—	—	623.934
1963	621.841	78.949	243.843	946.633
1964	629.503	61.579	223.022	999.104
1965	574.766	85.629	316.802	977.197
1966	545.727	93.320	323.625	964.672
1967	596.103	110.019	313.198	1.019.330
1968	584.570	113.225	336.251	1.034.046
1969	607.162	119.082	600.397	1.326.641
1970	610.403	116.113	683.446	1.409.962
1971	602.564	157.476	705.575	1.463.615
1972	599.058	202.291	686.104	1.487.453
1973	609.350	322.100	666.009	1.597.459
1974	631.111	370.349	701.124	1.702.584
1975	636.700	353.226	717.398	1.707.324

<sup>10</sup> Po aty, 106.

<sup>11</sup> AET — Pasqyrë e prodhimit të xeheve në periudhën 1961—1975 në xeheroren e Trepçës, Mitrovica e Titos, 1976, 3.

Me zhvillimin gjithnjë e më të hovshëm të xehetarisë, para subjekteve shoqërore shtrihet nevoja për ndërtimin e ri të kapaciteteve për përpunimin e xehes. Pasi bëhen analiza të tëra në vend dhe në botën e jashtme, të cilat jepin fryte, fillon instalimi i stabilimenteve për përpunimin e koncentratit të zinkut. Kështu, pas përgatitjeve të duhura, më 1964 në Mitrovicën e Titos fillon ndërtimi i elektrolizës së zinkut. Në periudhën 1965—1967 ndërtohet shkretorja e re e plumbit, përkatësisht fërgorja për fërgimin e koncentratit të plumbit dhe dy furra shahtesh të tipit „Port-piri”, pastaj filterat elektrostatikë si dhe stabilimentet për prodhimin e acidit sulfurik me kapacitet prej 70.000 tonë në vit. Kapaciteti i shkretores së plumbit është 150.000 tonë.<sup>12</sup>

Prodhimi i rregullt në elektrolizën e zinkut fillon në fund të vitit 1967. Përfitimi i zinkut, kadiumit, acidit sulfurik në elektrolizën e Trepçës bazohet në procesin më bashkëkohor teknologjik. Si lëndë e parë për elektrolizën e zinkut shfrytëzohet koncentrat i flotacionit nga minierat e kombinatit. Përveç zinkut elektrolit, në elektrolizën e zinkut prej të njëjtës lëndë të parë përfitohet acidit sulfurik dhe kadiumi elektrolit. Në elektrolizën e zinkut kryesisht nxirren dy ndërmjetprodukte me përmbajtje të konsideruar të metalit — lymbakri dhe lym-zink-hekuri. Me përpunimin e lymit të bakrit bëhet i mundshëm përfitimi i gurit të kaltër duke e shfrytëzuar njëkohësisht zinkun dhe kadiumin nga ky lym. Kurse lymi i zink-hekurit si ndërmjetprodukt përfitohet me sasi të mëdha, 30.000 tonë në vit. Ky kapacitet dyfishohet dhe vazhdon ndërtimi i kapaciteteve për përpunimin kimik e mekanik të zinkut e të kadiumit. Prodhimi i zinkut në elektrolizë mund të ndiqet si vijon.<sup>13</sup>

Viti	Zink në tonë	Lëgura në tonë
1967	3.637	—
1968	28.798	25
1969	27.770	641
1970	25.954	1.309
1971	22.983	1.147
1972	20.356	1.423
1973	24.583	1.429
1974	24.764	1.440
1975	28.898	1.202

Në Mitrovicën e Titos me rrethinë bazenet kryesore të plumbit dhe të zinkut janë Stari-Tërgu me rrethinë, Mazhiçi, Melelica, Zijaça, Vllahinja, Gumnishta etj.

Paralelisht me eksploatimin dhe përpunimin e xehes, në Trepçë i jepet rëndësi hulumtimeve gjeologjike për rezerva të reja. Në periudhën 1955—1959 Trepça ndan mjete të konsideruara për verifikimin e rezervave të xehes në lokalitetet e mëparshme në mesatare prej 110.000.000 din. në vit. Vetëm në hulumtime në hori-

<sup>12</sup> Kosova dikur e sot, Beograd, 1973, 519.

<sup>13</sup> AET, Prodhimtaria e zinkut prej vitit 1967—1975.

zonte të thella në vitin 1958 shpenzohen 88.390.000 dinarë. Kështu, për përtërirjen e mekanizmit në Stari Tërg në vitin 1959 investohen 180.000.000 dinarë. Përveç hulumtimeve plumb-zinkut, kujdes i duhur u kushtohet edhe hulumtimeve të xeheve të tjera si të aluminut, azbestit, laporcit etj. Rëndësi e veçantë u jepet hulumtimeve të azbestit, që si lëndë e parë importohet nga jashtë. Xehëja e azbestit zbulohet në këtë region qysh para luftës. Gjatë luftës gjermanët eksploatojnë xehen e azbestit, ndërsa pas luftës më shumë bëhen hulumtime sesa eksploatime. Kështu, nga viti 1953 vazhdojnë punët në mënyrë të organizuar për hulumtimin e kësaj xeheje. Në xeheroren (Kovaçicës) e azbestit në Rujisht në vitin 1955 bëhen 3.670 metra korridore për të vërtetuar rezervat e xeheve. Kështu, me këto shpuarje vërtetohet se në këtë lokalitet ka rezerva të xeheve së kategorisë „A”, 4.237 tonë, të kategorisë „B” 21.307 tonë të kategorisë „C” 11.250 tonë, përkatësisht 14.716 tonë pluhur të azbestit.<sup>14</sup> Për hulumtimet e azbestit në xeheroret e Kovaçicës në vitin 1958 investohen 15.000.000 dinarë, hulumtimet bëhen në një sipërfaqe prej 100 ha, duke hapur korridore në gjatësi prej 400 m dhe me shpurje të thellë në 1.260 m, ku vërtetohen 300.000 tonë rezerva azbest-pluhur. Kështu, për të vazhduar hulumtimet në këtë lokalitet, në vitin 1959 deponohen mjete në shumë prej 29.410.000 din.<sup>15</sup> Xeheroret e azbestit dhe seperati në Çabër fillojnë punën më 1958. Në përpunimin e pëlhurës së azbestit në fillim kjo ndërrmarje është rentabile dhe realizon një brutoproduct prej 110.000.000 din, ndërsa të ardhura të pastra 28.000.000 dinarë.<sup>16</sup> Por, ky sukses është i shkurtër. Qysh në fillim të prodhimit të rregull vërehet se vlerësimi i rezervave nuk është çmuar si duhet dhe së shpejti mungon xeheja si lëndë e parë, prandaj u duhet të kërkohen rezerva të reja edhe në lokalitete të tjera si në zonën e Kozarevës në gjatësi prej 27 km dhe gjerësi 2,5 km.

Më vonë në lokalitetin e azbestit në fshatin Pec në regjionin e Bajgorës 15 km në lindje të Stari Tërgut verifikohen rezerva të kësaj xeheje, 8.941.000 tonë ose 110.000 tonë pëlhurë, ku përmbajtja e azbestit me sepertimin produktiv varion prej 0,5—2%. Ndërsa sipërfaqe të mbuluara me tufë shihen në rrethinën e Zveçanit, në fushën e Leshakut dhe të Leposaviqit. Në anën e djathtë të lumit Ibër, në lokalitetin e laporcit „Dren”, verifikohen rezerva të konsideruara të laporcit të kuq, të verdhë dhe të kaltër të kategorizuar A, B 30.296.755 tonë dhe A+B+75.882.850 tonë. Po kështu bëhen hulumtime për laporc edhe në bjeshkën „Berim” të Çeçevës, madje vijën Kozarevë e deri te Koshutova u paraqitën sasira të kromit që deri tash nuk paraqesin ndonjë rëndësi ekonomike. Në sajë të hulumtimeve të bëra në Mazhiç konstatohen rezerva në 1,1 milionë tonë xehe me përmbajtje 9,2 Pb+Zn, madje

<sup>14</sup> Rudnici i topionica olova i cinka „Trepça”, Bilten, br. 1, Kos. Mitrovica, 1955.

<sup>15</sup> Ocena o sprovođenju perspektivnog plana privrednog razvoja opštine Stari Trg 1957, 61.

<sup>16</sup> Stanje i problemi privrednog razvitka koline, Zapisnik KM 1959.

në Zijaç rezervat arrijnë në 4,5 milionë tonë me përbërje 4% Pb+Zn.<sup>17</sup> Në kuadër të Kombinativit Trepça, ku xeheja përpunohet, përfshihen edhe xehoret e kompleksit të kopaonikut, Bello-Bërdës dhe shumë lokalitete të tjera, ku janë zbuluar xehe. Hulumtimet e bëra në këto lokalitete dhanë rezultate të frytshme dhe u verifikuan rezerva të mëdha të xehe me përmbajtje të madhe të Pb+Zn, që paraqesin bazë të sigurt për zhvillimin e xehetarisë në kuadër të Trepçës.

Pozita gjeografike e Mitrovicës së Titos me rrethinë dhe lidhjet e mira të komunikacionit, dhe pse në afërsi nuk ka male të mëdha, bënë të mundshëm zhvillimin e industrisë së drurit. Lidhjet e mira të komunikacionit, malet e larta buzë Ibrit, të Rozhajës, Mojtirit, Tutinit dhe Çeçevës paraqesin lëndën e rëndësishme për industrinë e drurit të Mitrovicës së Titos. Nga këto male lëndën e parë për një kohë të gjatë deri në Mitrovicë të Titos sillet nëpërmjet lumit Ibër, në sharra për t'u përpunuar. Pas qilimit, përveç xehetarisë, industria e drurit në këtë trevë paraqet degën kryesore të ekonomisë, e cila përbëhet prej dy sharrave elektrike. Në mundësi të ujit në lumin Ibër, sharrat në Mitrovicën e Titos fillojnë të punojnë në fund të vitit 1945. Vetëm gjatë dhjetorit të vitit 1946 në lumin Ibër lëshohen më se 4000 m<sup>3</sup> lëndë për nevojat e sharrave, ndërsa deri në mars të vitit 1947 në lumin Ibër lëshon 3.000 m<sup>3</sup>. Në malet e rajonit të bazenit të epërm të Ibrit gjatë vitit 1947 parashihen të prehen 80.000 m<sup>3</sup>.<sup>18</sup>

Në vitin 1947 themelohet ndërmarrja për përpunimin e drurit „Çeçevc”. Prodhimi kryesor i kësaj ndërmarrje janë produktet e drurit, si lënda e sharritur e pishës dhe e ahut, lëndë të gdhendura, lëndë për xehetari, si dhe lëndë për thëngjill të drurit. Prodhimin e lëndëve të drurit në këtë ndërmarrje në periudhë të caktuar mund ta ndjekim si vijon.<sup>19</sup>

Viti	Lëndë pishë dhe bungu të sharritura në tonë	Thëngjill druri në m <sup>3</sup>	Dru ahut për djetë në m <sup>3</sup>	Lëndë të gdhendura në m <sup>3</sup>	Lëndë xehetari m <sup>3</sup>
1947	800	—	—	—	—
1948	1 000	—	—	—	—
1949	1.300	140	800	—	—
1950	1.400	200	12.000	—	—
1951	1.450	—	—	400	—
1952	1.450	—	—	500	300
1953	1.510	—	—	800	500
1954	1.427	—	—	809	741

Ndërmarrja me lëndë të parë furnizohet kryesisht nga malet e afërta të ndërmarrjes. Kapaciteti i sharrës është 10 m<sup>3</sup> lëndë të sharritur brenda tetë orë pune. Në vitin 1954 në këtë ndërmarrje punojnë 25 punëtorë.<sup>20</sup>

<sup>17</sup> AET, Fascikli i hulumtimeve gjeologjike.

<sup>18</sup> *Këshilli Krahinor Popullor i Krahinës Autonome të Kosovës e Metohisë 1943—1953*, Prishtinë, 1955, 70.

<sup>19</sup> Si shënimi 1, 109.

<sup>20</sup> *Po aty*.

Në periudhën e ndërtimit socialist ndërmarrje me rëndësi për përpunimin e drurit në Mitrovicën e Titos është kombinati i drurit „Boris Kidriç”, në kuadrin e të cilit punojnë reparti i zdruk-tarisë, që ishte themeluar qysh para luftës, dhe fabrika e sipër dhe panel pllakave, e cila themelohet më 1947. Në këtë ndërmarrje prodhohen produkte të ndryshme të drurit. Në sajë të të dhënave nga viti 1955 del se kapaciteti vjetor është 12.000 m<sup>3</sup> lëndë pishë të sharritur, 600 m<sup>3</sup> lëndë të sharritura ahu, 1200 m<sup>3</sup> panel pllaka, 100 m<sup>3</sup> shperpllaka, 1000 m<sup>3</sup> ambalazhë 70 m<sup>3</sup> furnir të fisnikëruar, 1000 m<sup>3</sup> lëndë për xehetari, 16.000 m<sup>3</sup> lëndë, për djegie dhe 1400 m<sup>3</sup> trupa ahu për sharritje.<sup>21</sup> Me zgjerimin e kapaciteteve të përpunimit të drurit me këtë ndërmarrje zgjerohet edhe asortimenti i prodhimeve, ku përveç lëndëve të sharritura, ambalazh druri, prodhohen lloje të ndryshme të pllakave dhe të furnireve, materiale për ndërtimtari dritare, dyer dhe mobilje. Këtë prodhimtari të zgjeruar mund ta ndjekim në saje të të dhënave nga viti 1962, ku prodhimi fizik në „Kosmet shpert” është 1.761 m<sup>3</sup> pishë, çarr, bung dhe drunj të tjerë të sharritur, 52.286 copë shpatlla druri të standardizuar, 8.623 m<sup>3</sup> ambalazh të madh etj. Ndërsa në vitin 1963 prodhon 1.869 m<sup>3</sup> shper dhe panell plaka, 424 m furnir të arrës, frashëri dhe bingu, 1.325 garnitura për dhoma fjetjeje, 364 shifoniera, 2.792 shtretër fëmijësh dhe 130 fotele.<sup>22</sup>

Pas çlirimit në Mitrovicën e Titos bëhet nacionalizimi i atyre objekteve të vogla industriale që ishin në duar të pronarëve individualë, si mulliri në Zveçan bëhet me karakter Krahinor, ai automatik „Zveçan” në Mitrovicën e Titos dhe mulliri elektrik në Mitrovicë, kurse me karakter rrethi bëhen tre mullinj elektrikë dhe të gjithë mullinj të me ujë kanë karakter lokal dhe vihen në veprim për nevojat e popullit. Pas çlirimit në Mitrovicën e Titos me rrethinë ekzistojnë një numër furrash me karakter lokal që shërbyen për nevojat e popullit. Më 1957 ndërtohet furra moderne e bukës me pajisje më bashkëkohore me kapacitet ditor 44 tonë dhe atë vjetor 1320 tonë. Në këtë industri moderne shfrytëzimi i kapacitetit është më 1973 58,60%, në vitin 1974 58,36%, ndërsa më 1975 shfrytëzohen vetëm 48,02%.

Nga kjo del se as për së afërmi nuk janë shfrytëzuar instalimet moderne për pjekjen e bukës, njëkohësisht këtu vërehet se mungon milli, që do të thotë se duhet t'i jepet rëndësi grumbullimit të drithit, të ngrihen drithnikë modernë dhe mullinj për ta siguruar lëndën e parë për prodhimin e bukës.

Në Mitrovicën e Titos pas çlirimit ishin disa punishte e reparte të prodhimeve të ndryshme për plotësimin e nevojave të popullatës, kur më 1951 themelohet ndërmarrja „Zveçan”. Në kuadrin e kësaj ndërmarrje punojnë Fabrika e tjegullave në Mitrovicë, reparti i deltinës në Zhitkocv, ndërmarrja industriale për përpunimin e gurëve të mullirit në Boletin dhe reparti për prodhimin

<sup>21</sup> *Privreda našeg sreza u 1955*, Bilten br. 2, Kos. Mitrovica, 1955.

<sup>22</sup> Qazim Lleshi, *Funkcionalno obeležje triju večih gradova, Prizrena, Prištine i Mitrovice*, 1963, FMN nr. 2, Prishtinë, 1974, 318.

e gurëve katërorë (kocka) në Vllahinjë, Kullë dhe në lumin Ce-rajë, madje deri më 1952 në kuadër të kësaj ndërmarrje punoi edhe hidrocentrali elektrik me sharrën e Çeçevës. Në këtë ndërmarrje gjatë një sezoni mund të prodhoheshin produkte të ndryshme, në repartin e tjegullave në Mitrovicë 1.000.000 copë tjegulla dhe 60.000 copë tulla, në Zhitkovcë 3.000.000 copë tulla ndërsa në repartin e gurëve të mullinjve në Boletin 1000 gurë mulliri dhe në punishtet e prodhimit të gurëve katërorë (kockë) 3.000.000 copë. Në këtë ndërmarrje në të gjitha repartet punojnë gjithsej 350 punëtorë. Në të gjithë repartet punohet në mënyrë mjaft ekstensive. Po ato makina të vjetra çmontohen tek më 1954, në repartin e gurve u instalohen stabilimente të reja ku prodhimi shtohet në 8.000.000 copë gurë katërorë (kockë).<sup>23</sup>

Ndërmarrja metalo-zdruktare „Kosova” themelohet më 1946 dhe në fillim punon me dy reparte të zdrukthtarisë dhe të metaleve.

Në repartin e zdrukthtarisë prodhohen produkte të tipizuara për ndërtimtari, mobile dhe pajisje të ndryshme për zyre. Në këtë repart në vitin 1953 përpunohen rreth 600 m<sup>2</sup> lëndë.

Në repartin e metaleve në fillim bëhet riparimi (remonti) i automobilave, lokomotivave madje gradualisht në këtë repart fillon të prodhohen stufa e pjesë të tjera të metalit. Më 1949 në këtë repart fillon edhe prodhimi i enëve prej aluminiumi.

Më 1953 reparti i metaleve në kuadër të vet kishte repartin e automekanikës, makinerisë, metalgdhendësve, të farkatarisë dhe qerreve ku punojnë gjithsej 50 punëtorë.<sup>24</sup> Kjo ndërmarrje e vogël industriale bëhet objekt i industrisë metalike përpunuese që vazhdon ta furnizojë Trepçën me prodhime. Gradualisht me zgjerimin e veprimtarisë, sidomos pas vitit 1963, në bashkëpunim me „Crvena Zastava”, fillon të prodhojë rimorkio. Në këtë vit prodhon 300 rimorkio, ndërsa në vitin 1964 700 rimorkio.<sup>25</sup> Kjo ndërmarrje me zgjerimin e kapacitetit punon si ndërmarrje e specializuar për prodhimin e tipave më modernë dhe funksionalisht më të përsosur të rimorkiove në kuadër të kombinatit të Trepçës. Prodhimi në këtë ndërmarrje mbështetet në lëndën e parë të Trepçës.

Në periudhën pas çlirimit elektrifikimi i një pjese të qytetit bëhet nga hidrocentrali elektrik i ngritur para lufte në lumin e Çeçevës, madje nga centrali në lumin Ibër, e cila së shpejti e ndërpreu punën. Nevojat më të mëdha të qytetit dhe të rrethinës plotësohen nga termoelektrana e Trepçës. Hidrocentrali „Çeçevo” kishte kapacitetin e instaluar 432 KV, kurse mundësitë e prodhimit të energjisë elektrike ishin 350 KV/2. Në këtë hidrocentral në vitin 1954 prodhohen 1.628.000 KV orë energji elektrike. Për nevojat e tjera të qytetit dhe të rrethinës shfrytëzohet edhe termoelektrana e Trepçës.

Më 1952 në Mitrovicën e Titos themelohet Enti për fermentimin e duhanit që më vonë rritet në ndërmarrje për prodhimin,

<sup>23</sup> Si shënimi 1, 111.

<sup>24</sup> Po aty, 113.

<sup>25</sup> „Rilindja” od 2. februara 1964.

grumbullimin dhe gjysmë përpunimin e duhanit. Në vitet e para të themelimit kjo ndërmarrje arrin suksese të mira në prodhimin e duhanit, ku në vitin 1952 prodhon 314 tonë, më 1953 shton prodhimin në 718 tonë, ndërsa më 1954 ky prodhim arrin në 1000 tonë.<sup>26</sup> Në mungesë të lëndës së parë në këtë rejon kjo ndërmarrje nuk ishte rentabile. Lënia pas dore e bujqësisë, zvogëlimi i sipërfaqeve të mbjellura me këtë bimë industriale kontribuojnë që prodhimtaria e përgjithshme e kësaj ndërmarrjeje të zvogëlohet, që në vitin 1975 të prodhohen vetëm 603 tona.

Një përpjekje më intensive për zhvillimin e industrisë në Krahinë, pra dhe në Mitrovicën e Titos, fillon në vitet gjatë dhjetë. Më 1959 në këtë qytet bëjnë një analizë subjektet e ndryshme të Krahinës dhe të Mitrovicës së Titos për mundësit e shfrytëzimit të produkteve të Trepçës në prodhime finale. Në vitin 1959 merret vendimi për themelimin e fabrikës së akumulatorëve në Mitrovicën e Titos, ku si lëndë e parë shërben prodhimi i Trepçës. Në projektin orientues për këtë fabrikë parashihen investime të përgjithshme prej 1.500.000.000 deri 2.000.000.000 din. me kapacitet prej 3000 tonë akumulatorë të plumbit brenda viti me punë në një ndërrim. Për realizimin e kësaj prodhimtarie parashihen të shpenzohen 4000 tonë plumb dhe të inkuadrohen 150—200 punëtorë.<sup>27</sup> Pra, përgatitjet për themelimin e fabrikës së akumulatorëve fillojnë shumë herët, por realizimi i këtij kapaciteti të parë përpunues të kombinatit të Trepçës arrihet tek në vitin 1967, kur fillon prodhimi modest e më tepër eksperimental i akumulatorëve të plumbit prej 6000 tonësh në vit.<sup>28</sup> Me ndërtimin e kësaj fabrike plumbi i Trepçës për herë të parë fillon të përdoret për prodhimin e një produkti final. Prodhimi i akumulatorëve në këtë fabrikë bëhet sipas teknologjisë komplete moderne, ku përfshihet prodhimi i akumulatorëve të plumbit me të gjitha pjesët e tyre.

Prodhimi i akumulatorëve të plumbit me mbushje në këtë fabrikë kërkohen si në tregun e brendshëm, ashtu edhe në atë botëror. Prodhimi në stabilimentet e reja arrin në 30.000 tonë akumulatorë të rinj në vit, ku së shpejti prodhimi dyfishohet.<sup>29</sup>

Me zhvillimin e kësaj fabrike në këtë periudhë parashihen ndërtimi i kapaciteteve për prodhimin e burimeve kimike, të rrymës, duke shfrytëzuar edhe metalet e tjera të Trepçës. Në bazë të shfrytëzimit të zinkut në këtë kompleks ndërtohen kapacitetet komplete për prodhimin e baterive primare me asortiment më të madh të llojeve të tipave për përdorim të gjerë dhe bateri industriale plumbi. Në fabrikën e akumulatorëve në Mitrovicën e Titos caktohet kapaciteti i përgjithshëm i prodhimit në 52.000 tonë. Në kuadër të kësaj fabrike punon edhe fabrika e akumulatorëve në Sombor.

<sup>26</sup> Si shënimi 1, 114.

<sup>27</sup> Zapisnik o korišćenju sirovina „Trepče” i razvoj hemijske industrije i nekim drugim problemima održan 8. decembra 1959. godine u Zvečanu.

<sup>28</sup> APPK, *Informatë mbi aktivizimin e kapaciteteve industriale në KSA të Kosovës*, Prishtinë, 1972, 11.

<sup>29</sup> Si shënimi 16.

Ndërsa zhvillimin e industrisë kimike në këtë rejon mund ta ndjekim që nga fillimi i veprimtarisë të saj. Më 1961 ndërtohet fabrika e parë për prodhimin e acidit sulfurik, të plehrave të thjeshta artificiale me superfosfat në pluhur dhe granulla, e më vonë ndërtohen edhe kapacitete të tjera për prodhimin e plehrave komplekse NPK dhe për prodhimin e acidit sulfurik. Në kapacitetet e instaluara në Mitrovicën e Titos prodhohen një mori asortimesh kimike si acid sulfurik, superfosfat në pluhur, superfosfat në granulla, kriolit artificial, sulfat të aluminit dhe plehra të perziera NPK.<sup>30</sup>

Stabilimentet e instaluara për prodhimin e acidit sulfurik, në sajë të licencës së fabrikës gjermane „Hygo-Petersen”, arrijnë kapacitetin teknik prej 120.000 tonë në vit. Ndërsa fabrika për prodhimin e superfosfatit në pluhur dhe granulla pajisjet me stabilimente të firmës franceze „Marites” me kapacitet të superfosfatit në pluhur 250.000 tonë dhe superfosfat në granulla 100.000 tonë në vit.<sup>31</sup> Më 1970 fillon prodhimi i plehrave komplekse me kapacitet teknik 144.000 tonë në vit. Kurse më 1975 vihet në shfrytëzim fabrika për prodhimin e fosforpentoksidit ( $P_2O_5$ ) me kapacitet 50.000 tonë në vit.<sup>32</sup> Në kuadër të industrisë kimike në këto fabrika prodhohen edhe krioliti artificial dhe sulfati i aluminit. Në kuadër të kombinatit „Trepça” punon edhe laboratoritë me pajisje bashkëkohore ku analizohet cilësia e lëndës së parë dhe e prodhimeve.

Në sajë të lëndës së parë të Trepçës, në Kosovë ngrihen disa kapacitete për finalizimin e prodhimit, si reparti në „Famipë” në Prizren më 1971, ku përpunohet argjendi dhe mund të finalizohen edhe metale të tjera të çmueshme të Trepçës, si ari etj. Po kështu, në sajë të lëndës së Trepçës ngrihet fabrika e municionit të gjëtisë dhe ajo e lodrave në Serbicë, madje e radiatorëve në Gjilan dhe e baterive në Pejë, ajo kimike dhe e llamarinës në Vuçitërnë etj.

Për nevojat e industrisë dhe të bujqësisë në lumin Ibër më 1972 filluan punët në hidrosistemin „Ibër”. Në fshatin Gazivod 30 km në perëndim të Mitrovicës së Titos ndërtohet penda „Gazivoda” me akumulimin e shfrytëzueshëm të ujit prej 360 milion  $m^3$ , madje penda „Pridvorica” me bazenin kompensues dhe akumulimin e shfrytëzimit prej 500.000  $m^3$ . Nga akumulimi i ujit ngrihet hidrocentrali me fuqi instaluese prej 34 mw në vit në prodhimin e energjisë elektrike prej 100 milion KWh, ngrihet larg përçesi Mitrovicë e Titos Gazivodë.

Me ngritjen e këtyre kapaciteteve industriale në këtë trevë bëhet e mundur të inkuadrohet një numër i konsideruar i punëtorëve dhe krijohen parakushte për ndryshimin e strukturës ekonomike që pati rëndësi të veçantë në transformimin ekonomik shoqëror e kulturor të kësaj treve.

<sup>30</sup> AET, fascikla proizvodnja — F—7.

<sup>31</sup> Si shënimi 9.

<sup>32</sup> APPK, *Informata mbi aktivizimin e kapaciteteve industriale në KSA të Kosovës*, Prishtinë, 1975, 39.

*Dr. Tahir Abdyl*

LE DEVELOPPEMENT DE LA MINÉRALOGIE ET DE L'INDUSTRIE  
À MITROVICÉ DE TITO PENDANT LA PÉRIODE  
DE L'ÉDIFICATION SOCIALISTE

R é s u m é

Mitrovicé de Tito et ses environs représentent une contrée d'un sous sol assez riche depuis le temps le plus reculés, au Moyen âge et surtout pendant les deux guerres mondiales. Dans ses mines, pendant les deux guerres mondiales commencèrent les recherches géologiques par le capital étranger dont le résultat final de ces recherches était l'entreprise des creusage et l'élaboration des mines de Trepça en 1929.

La minéralogie, avant, pendant et après la guerre nationale libérale dans cette contrée fut et resta la branche principale de l'économie. Dans la période socialiste, le développement de la minéralogie permit la mise sur pied des diverses capacités industrielles où furent employés un grand nombre d'ouvriers et ainsi se créèrent des préconditions d'un changement de la structure économique et eut une grande importance dans la transformation économicosociale et culturelle dans cette contrée.

